



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052, për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr. 03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

**D e k r e t o j**

Ratifikimin e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë ligjore në Çështjet Penale, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë, e nënshkruar në Prishtinë më 11 maj 2012, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 23 maj 2012.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-002-2012

Prishtinë, më 01 qershor 2012

  
Atifete Jahjaga  
Presidente e Republikës së Kosovës

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET**  
**REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**DHE**  
**REPUBLIKËS SË KROACISË**  
**PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË LIGJORE NË ÇËSHTJET PENALE**

Republika e Kosovës dhe Republika e Kroacisë, këtu e tutje të referuara si “Palët”,

Në aspiratat e tyre për zhvillimin dhe forcimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale në fushën e ndihmës ligjore të ndërsjellë në çështjet penale ndërmjet dy vendeve,

Duke marrë parasysh miqësinë dhe bashkëpunimin ekzistues ndërmjet dy vendeve dhe gatishmërinë e tyre për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit në Evropë,

Janë pajtuar me si vijon:

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Fushëveprimi i ndihmës së ndërsjellë ligjore**

- (1) Palët marrin përsipër t’i ofrojnë njëra-tjetrës, në përputhje me këtë Marrëveshje, masat më të gjëra të ndihmës së ndërsjellë ligjore në çështjet penale në lidhje me veprat dhe ndëshkimet të cilat, në kohën e parashtrimit të kërkesës për ndihmë bien nën juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese.
- (2) Autoritetet gjyqësore të të dyja Palëve, në përputhje me këtë Marrëveshje, do t’i ofrojnë ndihmë ligjore autoriteteve tjera të cilat në bazë të ligjeve të Palës tjetër, janë kompetente për çështjet e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni.
- (3) Kjo Marrëveshje nuk do të zbatohet lidhur me arrestimet, ekzekutimin e vendimeve, apo lidhur me veprat e parapara me ligjin ushtarak të cilat nuk janë të parapara si vepra penale me të drejtën penale të zakonshme.

**Neni 2**  
**Kanali dhe gjuha e komunikimit**

- (1) Palët duhet të dorëzojnë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore përmes autoriteteve të tyre kompetente, si vijon:
  - a) Për Republikën e Kosovës: përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës;
  - b) Për Republikën e Kroacisë: përmes Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kroacisë .

- (2) Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë ligjore dhe dokumentet përcjellëse duhet të përcillen në origjinale ose në kopje të certifikuara.
- (3) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze për Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe në gjuhën kroate ose angleze për Ministrinë e Drejtësisë së Republikë së Kroacisë.
- (4) Në raste urgjente, kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore mund të përcillen përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol). Kopjet e kërkesës së tillë duhet t'i përcillen në të njëjtën kohë edhe Ministrisë së Drejtësisë së Palës së kërkuar.
- (5) Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk e përjashtojnë mundësinë e komunikimit përmes kanaleve diplomatike nëse është e nevojshme.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat për ndihmë ligjore reciproke**

- (1) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore të hartuara në përputhje me këtë Marrëveshje do të parashtrihen nga organi gjyqësor ose nga ndonjë organ kompetent tjetër i Palës kërkuese dhe do t'i adresohet organit kompetent gjyqësor ose ndonjë organi tjetër kompetent të Palës së kërkuar.
- (2) Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore duhet të përfshijnë si vijon:
  - a) Organin që parashtron kërkesën;
  - b) Objektin dhe arsyen e kërkesës;
  - c) Identitetin dhe shtetësinë e të pandehurit dhe/ose të personit në fjalë nëse është e mundur;
  - d) Kur është e nevojshme, emrin dhe adresën e personit tek i cili/e cila duhet të bëhet dorëzimi;
  - e) Përshkrimin e fakteve dhe kualifikimin ligjor të veprës për të cilën është duke u zhvilluar procedura penale;
  - f) Nëse është e nevojshme, pyetjet të cilat duhet t'i parashtrihen personave, ekzaminimi i të cilëve kërkohet.
- (3) Pala e kërkuar mund të kërkojë përcjelljen e informatave dhe dokumenteve shtesë nëse e konsideron të nevojshme për ekzekutimin e kërkesës.
- (4) Kërkesa dhe dokumentet përcjellëse duhet të nënshkruhen dhe vulosen nga autoriteti kompetent i Palës kërkuese. Nuk duhet të kërkohet vërtetim shtesë.

### **Neni 4**

#### **Refuzimi i ndihmës së ndërsjellë ligjore**

- (1) Pala e kërkuar mund të refuzojë kërkesën për ndihmë të ndërsjellë ligjore nëse konsideron se ekzekutimi i kërkesës mund të cenoj sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesat esenciale tjera të shtetit.
- (2) Pala e kërkuar do të refuzojë kërkesën për ndihmë të ndërsjellë ligjore nëse ndërlihet me:
  - a) Një vepër e cila në bazë të ligjit të Palës së kërkuar nuk paraqet vepër penale;

- b) Një vepër të cilën Pala e kërkuar e konsideron si vepër politike apo vepër të ndërlidhur me një vepër politike.
- (3) Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, veprat në vijim nuk duhet të konsiderohen si vepra politike ose vepra të ndërlidhura me një vepër politike:
- a) Vrasja ose tentim vrasja e Kryetarit të Shtetit ose ndonjë anëtar të familjes së tij/saj;
  - b) Krimet kundër njerëzimit të specifikuara në Konventën për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, të miratuar me 9 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara;
  - c) Shkeljet e specifikuara në nenin 50 të Konventës së Gjenevës për Përmirësimin e Kushteve të të Lënduarve dhe të Sëmurëve në Forcat Ushtarake në Terren, e 12 gushtit 1949, nenin 51 i Konventës së Gjenevës për Përmirësimin e Kushteve të të Lënduarve, të Sëmurëve dhe Anëtarëve të Anijeve të Shkatërruara të Forcave të Armatosura në Det e 12 gushtit 1949, nenin 130 i Konventës së Gjenevës në lidhje me Trajtimin e të Burgosurve të Luftës, të 12 gushtit 1949, dhe nenin 147 i Konventës së Gjenevës në lidhje me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë të Luftës e 12 gushtit 1949;
  - d) Çdo shkelje e krahasueshme e zakoneve të luftës, që ka efekt në kohën kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi;
  - e) Veprat brenda spektrit të Konventës mbi Shtypjen e Rrëmbimit të Kundërligjshëm të Fluturakes, e miratuar në Hagë me 16 dhjetor 1970;
  - f) Veprat brenda spektrit të Konventës mbi Shtypjen e Akteve të Kundërligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, miratuar në Montreal me 23 shtator 1971;
  - g) Vepër serioze që përfshin sulmin kundër jetës, integritetit fizik ose lirisë së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, përfshirë agjentët diplomatik;
  - h) Vepra që përfshin kidnapimin, marrjen e pengjeve ose mbajtjen serioze të paligjshme;
  - i) Vepra që përfshin përdorimin e bombës, granatës, raketës, pushkëve automatike ose bombës së dërguar me letër apo pako, nëse ky përdorim rrezikon personat.
- (4) Megjithatë, përveç veprave të referuara në paragrafin 3 të këtij neni, veprat në vijim nuk duhet të konsiderohen si vepra politike ose si vepra të ndërlidhura me vepër politike:
- a) Vepra serioze që përfshin aktin e dhunës ndaj jetës, integritetit fizik dhe lirisë së një personi;
  - b) Vepra serioze që përfshin aktin kundër pronës që ka shkaktuar rrezik kolektiv për personat.

## **Neni 5** **Ekzekutimi i kërkesave**

- (1) Pala e kërkuar duhet të ekzekutoj kërkesën për ndihmë të ndërsjellë ligjore në përputhje me procedurën dhe në mënyrë e paraparë me ligjin e saj.
- (2) Pala e kërkuar mund të aplikojë, në bazë të kërkesës, një procedurë të veçantë të kërkuar nga Pala kërkuese për ekzekutimin e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë ligjore deri në atë masë që procedura e tillë të jetë në përputhje me ligjet e veta.
- (3) Zyrtarë të Palës kërkuese dhe persona tjerë të interesuar ose përfaqësuesit e tyre mund të jenë të pranishëm, si vëzhgues, gjatë ekzekutimit të kërkesës për ndihmë ligjore reciproke, nëse Pala e kërkuar jep pëlqimin për këtë.

- (4) Për këtë qëllim dhe pas kërkesës specifike të Palës kërkuese, Pala e kërkuar duhet të informojë këtë të fundit për datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë ligjore reciproke.
- (5) Kërkesat për praninë e zyrtarëve të tillë ose personave me interes nuk duhet të refuzohen nëse prania e tillë e bën ekzekutimin e kërkesës për ndihmë të ndërsjellë ligjore më të përgjegjshme ndaj nevojave të Palës kërkuese, dhe në këtë mënyrë shmang nevojën për kërkesa plotësuese për ndihmë të ndërsjellë ligjore.
- (6) Në rastet kur Pala e kërkuar konstaton që kërkesa për ndihmë të ndërsjellë ligjore nuk mund të përmbushet, atëherë duhet të informojë Palën kërkuese menjëherë dhe të specifikojë arsyet e mospërmbushjes. Kërkesa origjinale dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet t'i kthehen Palës kërkuese pa vonesë.
- (7) Pas ekzekutimit të kërkesës për ndihmë ligjore reciproke, Pala e kërkuar duhet t'i përcjellë kopjet e certifikuara të të dhënave ose dokumenteve të kërkuara, përveç nëse Pala kërkuese shprehimisht kërkon përcjelljen e origjinaleve.

#### **Neni 6** **Konfiskimi dhe dorëzimi i pasurisë**

- (1) Kërkesa për konfiskim dhe dorëzim të pasurisë duhet të mbështetet nga vendimi i organit kompetent gjyqësor të Palës kërkuese që urdhëron konfiskimin e asaj pasurie.
- (2) Pala e kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e pronës, të dhënave ose dokumenteve të kërkuara nëse prona, të dhënat ose dokumentet në fjalë kërkohen për qëllime të procedurave penale të veta të papërfunduara.
- (3) Prona, të dhënat origjinale ose dokumentet e dorëzuara tek Pala kërkuese gjatë ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë ligjore, duhet t'i kthehen Palës së kërkuar sa më shpejt që është e mundur, përveç nëse kjo e fundit heq dorë nga kthimi.
- (4) Paragrafët (1) deri (3) të këtij neni nuk do të cenojnë interesat legjitime të personave me interes, përfshi palët e treta *bona fides*, në lidhje me pasurinë e konfiskuar dhe të dorëzuar.

### **KAPITULLI II** **DORËZIMI I THIRRJEVE DHE DOKUMENTEVE GJYQËSORE,** **PARAQITJA E DËSHMITARËVE, EKSPERTËVE DËSHMITARË DHE TË** **PANDEHURËVE**

#### **Neni 7** **Dorëzimi i akteve procedurale**

- (1) Dorëzimi dëshmohet përmes fletëdërgesës që përmban datën dhe nënshkrimin të personit tek i cili/e cila është bërë dorëzimi ose përmes deklaratës së bërë nga Pala e kërkuar që shërbimi është ekzekutuar, që përmban formën dhe datën e shërbimit të tillë. Njëra prej këtyre dokumenteve duhet t'i përcillet menjëherë Palës kërkuese.

- (2) Kërkesat për dorëzim të letërthirrjes për të pandehurin duhet t'i përcillet Ministrisë së Drejtësisë së Palës së kërkuar jo më vonë se 45 ditë para datës së paraparë për paraqitje të pandehurit në territorin e Palës kërkuese.
- (3) Thirrjet nuk duhet të përmbajnë njoftimin për masat kufizuese që duhet të aplikohen nëse dëshmitari ose dëshmitari ekspert i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet. Thirrjet që përmbajnë njoftimin për masat kufizuese duhet të dorëzohen, por dëshmitari ose dëshmitari ekspert që nuk paraqitet nuk duhet të dënohet ose t'i nënshtrohet masave kufizuese në territorin e Palës së kërkuar.
- (4) Nëse Pala kërkuese konsideron se paraqitja personale e një dëshmitari ose dëshmitari ekspert para autoriteteve të veta gjyqësore është e domosdoshme, atëherë duhet të potencojë atë në kërkesën për dorëzim të thirrjes dhe Pala e kërkuar duhet të ftojë dëshmitarin ose dëshmitarin ekspert që të paraqitet. Pala e kërkuar duhet të informojë Palën kërkuese për përgjigjen e dëshmitarit ose dëshmitarit ekspert.

### **Neni 8 Mëditjet dhe shpenzimet**

- (1) Dëshmitari ose dëshmitari ekspert i thirrur në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, dhe i cili paraqitet, ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të cilat duhet të mbulohen nga Pala kërkuese në përputhje me ligjet e veta.
- (2) Kërkesa ose letërthirrja duhet të përmbajë shumën e përafërt të shpenzimeve që do të kompensohen.

### **Neni 9 Garancitë për lirinë personale**

- (1) Një dëshmitar ose ekspert dëshmitar, pavarësisht nga shtetësia e tij/saj, i cili paraqitet pas ftesës nga Pala kërkuese, nuk duhet të ndiqet penalisht, ndalohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale të tij/saj në territorin e saj në lidhje me veprat e kryera ose dënimet e shqiptuara para nisjes së tij/saj nga territori i Palës së kërkuar.
- (2) Një person, pavarësisht nga shtetësia e tij/saj, i/e thirrur para autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese si i pandehur për t'u përgjigjur për aktet për të cilat ai/ajo akuzohet, nuk duhet të ndiqet, ndalohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në territorin e saj në lidhje me veprat e kryera ose dënimet e shqiptuara para nisjes së tij/saj nga territori i Palës së kërkuar dhe të cilat nuk janë të specifikuar në letërthirrje.
- (3) Vlefshmëria e garancive të parapara me këtë nen duhet të pushojë nëse:
  - a) Dëshmitari, eksperti dëshmitar ose i pandehuri mbetet në territorin e Palës së kërkuar më shumë se pesëmbëdhjetë ditë prej kur prania e tij/saj nuk është e nevojshme nga autoritetet gjyqësore edhe pse ai/ajo ka pasur mundësinë të largohet nga territori;
  - b) Dëshmitari, dëshmitari ekspert ose i pandehuri, pas lëshimit të Palës kërkuese, kthehet në territorin e saj në mënyrë vullnetare.

### **Neni 10**

### **Dorëzimi i përkohshëm i të pandehurve**

- (1) Nëse cilado Palë thërret si dëshmitar ose për qëllime të konfrontimit, të pandehurin nga Pala tjetër, i pandehuri, pas dhënies së pëlqimit, duhet t'i dorëzohet përkohësisht Palës kërkuese me kusht që ai/ajo të kthehet brenda periudhës së paraparë nga Pala e kërkuar.
- (2) Dorëzimi i të pandehurit mund të refuzohet nëse:
  - a) Dorëzimi i zgjat paraburgimin e tij/saj, ose
  - b) Ka arsytetime tjera të bazuara për mos dorëzim të tij/saj te Pala kërkuese.
- (3) Dorëzimi i të pandehurit mund të shtyhet nëse prania e tij/saj është e domosdoshme në procedurën penale që zhvillohet në territorin e Palës së kërkuar.
- (4) Në rast të dorëzimit të përkohshëm të të pandehurit nga Shteti i tretë të njëra nga Palët, përmes territorit të palës tjetër, kjo e fundit, në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet të lejojë transitin e tij/saj përmes territorit të vet me kusht që i pandehuri të mos jetë shtetas i saj.
- (5) Personi i dorëzuar duhet të mbahet në paraburgim në territorin e Palës kërkuese dhe në rastet kur aplikohet, edhe në territorin e Palës përmes territorit të të cilit lejohet transitit, përveç nëse Pala nga e cila kërkohet dorëzimi kërkon lirimin e tij/saj.
- (6) Në rastet kur qëllimi i specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni plotësohet, Pala kërkuese duhet të kthejë menjëherë personin e dorëzuar, te Pala e kërkuar përveç nëse kjo e fundit kërkon lirimin e tij/saj. Personi i dorëzuar ka të drejtat e specifikuara në nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje.

### **Neni 11**

#### **Dëgjimi përmes video-konferencës**

- (1) Në rastet kur personi që gjendet në territorin e cilësdo Palë duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert dëshmitar nga organet gjyqësore të Palës tjetër, kjo e fundit, nëse nuk është e dëshirueshme ose e mundshme që personi të paraqitet në territorin e saj personalisht, mund të kërkojë dëgjimin përmes video-konferencës, siç parashihet me paragrafët 2 deri në 7 të këtij neni.
- (2) Pala e kërkuar duhet të pajtohet për dëgjim përmes video-konferencës me kusht që ka mjetet teknike për të realizuar dëgjimin. Nëse Pala e kërkuar nuk ka qasje në mjete teknike për video-konferencë, atëherë mjetet e tilla mund të sigurohen nga Pala kërkuese përmes marrëveshjes reciproke.
- (3) Përveç informatave të parapara me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për dëgjim përmes video-konferencës duhet të përmbajë:
  - a) Arsyen pse nuk është e dëshirueshme ose e mundshme që dëshmitari ose eksperti të paraqitet personalisht;
  - b) Titullin e organit gjyqësor dhe emrin e personave të cilët do të bëjnë dëgjimin.
- (4) Organi gjyqësor i Palës së kërkuar duhet të thërret personin e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, në përputhje me procedurën e paraparë me ligjet e veta.
- (5) Sa i përket dëgjimit me video-konferencë, duhet të vlejné rregullat në vijim:

- a) Organi gjyqësor i Palës së kërkuar duhet të jetë i pranishëm gjatë dëgjimit, nëse e domosdoshme i shoqëruar me përkthyes dhe duhet të jetë përgjegjës për të siguruar identifikimin e personit që duhet dëgjuar dhe respektimin e parimeve fundamentale të ligjeve të Palës së kërkuar. Nëse organi gjyqësor i Palës së kërkuar mendon se gjatë dëgjimit parimet fundamentale të ligjit të Palës së kërkuar janë duke u shkelur, atëherë menjëherë duhet të ndërmerr masa të domosdoshme për të siguruar që dëgjimi të vazhdojë në përputhje me parimet e lartpërmendura;
  - b) Masat për mbrojtjen e personit që duhet dëgjuar duhet të miratohen, nëse është e nevojshme, ndërmjet autoriteteve kompetente të të dyja Palëve;
  - c) Dëgjimi duhet të bëhet nën drejtimin e autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese në përputhje me ligjet e veta;
  - d) Me kërkesë të Palës kërkuese ose të personit që duhet dëgjuar, Pala e kërkuar duhet të sigurojë që personi që duhet dëgjuar të ndihmohet nga përkthyesi nëse është e nevojshme;
  - e) Personi që duhet dëgjuar ka të drejtën e refuzimit të dhënies së dëshmisë në përputhje me ligjin e cilëso Palë.
- (6) Pa paragjykuar masat e miratuara për mbrojtjen e personave, organi gjyqësor i Palës së kërkuar duhet të hartojë procesverbalin e dëgjimit, duke përfshirë:
- a) Datën dhe vendin e dëgjimit;
  - b) Identitetin e personit të dëgjuar;
  - c) Identitetet dhe funksionet e personave të tjera në Palën e kërkuar që marrin pjesë në dëgjim;
  - d) Betimet e dhëna; dhe
  - e) Kushtet teknike nën të cilat është realizuar dëgjimi.
- (7) Secila Palë duhet të ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që, kur dëshmitarët ose dëshmitarët ekspert që dëgjoen brenda territorit të vet në përputhje me këtë nen, dhe që refuzojnë të dëshmojnë, përderisa janë të obliguar të dëshmojnë, ose të cilët nuk dëshmojnë të vërtetën, do të zbatohen ligjet vendore në të njëjtën mënyrë sikur dëgjimi të mbahej në procedurë penale vendore.

### **KAPITULLI III MARRJA PËRSIPËR E PROCEDURËS PENALE**

#### **Neni 12 Kushtet për marrjen përsipër të procedurës penale**

- (1) Nëse shtetasi i njëjës Palë ose personi që jeton në territorin e saj kryen në territorin e Palës tjetër një vepër të dënueshme me ligjet e të dy Palëve, atëherë Pala në territorin e të cilës është kryer vepra mund t'i kërkojë Palës tjetër që të merr përsipër procedurën penale.
- (2) Organi kompetent gjyqësor i Palës së kërkuar duhet të kryejë procedurat penale në përputhje me ligjin e vet.

#### **Neni 13 Kërkesat për marrjen përsipër të procedurës penale**



- (1) Kërkesat për marrjen përsipër të procedurës penale duhet të përmbajnë një përshkrim faktik të veprës dhe të dhënat rreth të pandehurit, shtetësinë e tij/saj dhe vendbanimin e tij/saj.
- (2) Kërkesat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të kenë të bashkëngjitur:
  - a) Dosjen origjinale ose kopjen e certifikuar;
  - b) Ekstrakte nga dispozitat e të drejtës penale të zbatueshme në rastin penal përkatës.

#### **Neni 14** **Ndjekja penale në Palën kërkuese**

Në rastet kur Pala kërkuese kërkon marrjen përsipër të procedurës penale, atëherë ajo nuk do të mund të ndjekë penalisht të pandehurin për veprën për të cilën kërkohet marrja përsipër e procedurës penale. Megjithatë, Pala kërkuese duhet të ketë të drejtën e ndërmarrjes së të gjitha hapave në lidhje me ndjekjen penale deri sa:

- a) Organi gjyqësor kompetent i Palës së kërkuar përfundimisht ndërpret procedurën penale sepse nuk ka dëshmi që i pandehuri ka kryer veprën ose për shkak se vepra për të cilin ngarkohet i pandehuri nuk paraqet veprën penale;
- b) I pandehuri përfundimisht lirohet nga akuza në Palën e kërkuar;
- c) Vendimi gjyqësor i marrë në Palën e kërkuar ekzekutohet ose ekzekutimi i tij bëhet i pamundur në bazë të ligjeve ose të faljes ose amnistisë ose për shkak të parashkrimit në bazë të ligjit të Palës së kërkuar.

#### **Neni 15** **Obligimi për të informuar**

Pala e kërkuar duhet të informojë Palën kërkuese rreth rezultatit të procedurës penale të iniciuar përmes kërkesës për marrjen përsipër të procedurës penale si dhe të dorëzojë vendimin final ose kopjen e certifikuar të tij.

### **KAPITULLI IV** **DISPOZITAT E NDRYSHME**

#### **Neni 16** **Informatat nga regjistrat penal**

Secila Palë duhet t'i përcjellë informatat nga regjistrat penal sipas kërkesës së organeve gjyqësore të Palës tjetër në masë të njëjtë sikur kërkesa të ishte bërë nga organet e veta gjyqësore.

#### **Neni 17** **Shkëmbimi i informatave nga regjistrat penal**

- (1) Palët duhet të shkëmbejnë informata nga regjistrat penal në lidhje me shtetasit e Palës tjetër.

- (2) Informatat duhet të shkëmbehen çdo gjashtë muaj ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kroacisë .
- (3) Pala e cila ka informuar Palën tjetër rreth të dhënave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, sipas kërkesës të të fundit, duhet t'i përcjellë vendimet ose kopjet e certifikuara si dhe të dhënat rreth dënimeve me qëllim të shqyrtimit nëse ato kërkojnë marrjen e masave sipas ligjeve të veta.

### **Neni 18 Konfidencialiteti**

Pala kërkuese mund të kërkojë që Pala e kërkuar të ruajë si konfidenciale faktin e dorëzimit të kërkesës si dhe të përmbajtjes së saj, deri në atë masë sa është e nevojshme për ekzekutim të kërkesës. Nëse Pala e kërkuar nuk mund të veprojë në përputhje me kërkesën e konfidencialitetit, atëherë duhet të informojë Palën kërkuese për këtë brenda një afati të arsyeshëm.

### **Neni 19 Mbrojtja e të dhënave personale**

- (1) Pala, të cilës i janë përcjellë të dhënat personale nga Pala tjetër si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, mund t'i shfrytëzojë ato vetëm për:
  - a) Qëllime të procedurave penale për të cilat vlen kjo Marrëveshje;
  - b) Procedura tjera gjyqësore ose administrative të ndërlidhura drejtpërsëdrejti me procedurën penale të referuara në pikën a);
  - c) Parandalimin e kërcënimit të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike.
- (2) Në rastet kur përcjellja e të dhënave personale ka mundur të refuzohet ose shfrytëzimi i tyre ka mundur të kufizohet nga Pala e kërkuar, Pala kërkuese nuk mund t'i shfrytëzojë ato për qëllimet e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni pa pëlqimin paraprak të Palës së kërkuar.
- (3) Të dhënat e tilla mund të përdoren për qëllime tjera nëse për këtë është dhënë pëlqimi nga Pala e kërkuar.
- (4) Secila Palë mund të refuzojë përcjelljen e të dhënave personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje nëse:
  - a) Të dhënat e tilla janë të mbrojtura me ligjet e veta; dhe
  - b) Pala të cilës duhet t'i përcillen të dhënat nuk parasheh mbrojtjen e individëve rreth përpunimit automatik të të dhënave personale deri në atë masë sa janë të ndaluara nga marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse, përveç nëse Pala e fundit merr përsipër të bëjë mbrojtjen e të dhënave personale të tilla siç kërkohet nga Pala tjetër.
- (5) Pala e cila ka përcjellë të dhënat personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, mund të kërkojë nga Pala tjetër të jep informata rreth përdorimit të atyre të dhënave.

**Neni 20**  
**Shpenzimet e ndihmës së ndërsjellë ligjore**

- (1) Secila Palë duhet të merr përsipër shpenzimet e ekzekutimit të kërkesës për ndihmë të ndërsjellë ligjore të shkaktuara në territorin e vet, përveç rasteve në vijim për të cilat Pala kërkuese duhet të bëjë kompensimin:
  - a) Pagesat për dëshmitarët ekspertë dhe shpenzimet e ekspertizës të shkaktuara në territorin e Palës së kërkuar;
  - b) Shpenzimet e dorëzimit të përkohshëm të personit të pandehur të kryer në përputhje me nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje;
  - c) Shpenzimet e vendosjes dhe kryerjes së linkut video-konferencës në Palën e kërkuar, pagesën e përkthyesve dhe shpenzimet e dëshmitarëve të cilat janë paguar nga Pala e kërkuar në përputhje me ligjet e saj, përveç nëse Palët pajtohen ndryshe.
- (2) Pala e kërkuar duhet të informojë Palën kërkuese rreth shumës së shpenzimeve të referuar në paragrafin 1 të këtij neni.
- (3) Ekspertiza mund të kushtëzohet nga depozitimi i avancit te organet gjyqësore kompetente të Palës së kërkuar.
- (4) Pa paragjykuar kompensimin e shpenzimeve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, Palët duhet të konsultohen me njëra-tjetrën me qëllim të arritjes së marrëveshjes rreth formës së pagesës së shpenzimeve të jashtëzakonshme dhe substanciale të cilat janë shkaktuar gjatë ekzekutimit të kërkesave.

**Neni 21**  
**Informatat rreth ligjeve**

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kroacisë duhet t'i ofrojnë njëra-tjetrës sipas kërkesës tekstin e dispozitave ligjore në fuqi ose që kanë qenë në fuqi në territorin e Palëve si dhe informatat rreth çështjeve të caktuara ligjore.

**KAPITULLI V**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 22**  
**Zgjidhja e kontesteve**

Çdo kontest rreth interpretimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhet nga Palët përmes kanaleve diplomatike.


**Neni 23**  
**Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe ndërprerja**

- (1) Kjo Marrëveshje duhet të hyjë në fuqi në datën e pranimit të njoftimit të fundit me shkrim përmes të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, se procedurat e brendshme ligjore të domosdoshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përfunduar.

- (2) Kjo marrëveshje lidhet për një afat të pakufizuar. Secila Palë mund të ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë përmes dërgimit të njoftimit me shkrim Palës tjetër, përmes kanaleve diplomatike, gjashtë muaj para datës së menduar të ndërprerjes.
- (3) Kjo Marrëveshje duhet të zbatohet përkohësisht nga data e nënshkrimit.

Përpiluar në Prishtinë në ditën e njëmbëdhjetë të muajit Maj të vitit 2012 në dy origjinale, në gjuhën shqipe, serbe, kroate dhe angleze, dhe të gjitha tekstet janë autentike në mënyrë të barasvlershme. Në rast të mospërputhjeve në përkthim, teksti i gjuhën angleze do të mbizotërojë.

**PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS**

  
Hajredin KUÇI  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Drejtësisë

**PËR REPUBLIKËN E KROACISË**

  
Orsat MILJENIĆ  
Ministër i Drejtësisë